

PROCESVERBAL

Mledhja e 02 e Rregullt e Asamblese Komunale është mbajtur me datë 28.02.2020 në ora 10:00 ne sallën e Asamblesë Komunale.

Mbledhja është udhehequr nga Kryesuesi i Kuvendit Z.Buyar Mazrek.
Në mledhje kanë marrë pjesë 14 anëtarë

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtar të Asamblesë, të nderuar misafirë mirë se erdhët në mbledhjen e 02 të rregullt të Asamblese Komunale për vitin 2020. Mledhja është mbajtur në ora 10:00.

Rendi i dites:

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;
2. Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;
3. Shqyrtimi dhe miratimi i memorandum mirëkuptimit për “Qendrën për strehimin e grave dhe fëmijëve”
4. Propozim ndryshimi i anëtarit të KKS-së nga radhët e bizneseve.
5. Të ndryshme.

1.Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të nderuar anëtarë , a ka dikush diçka me shtu në lidhje me procesverbal, nëse jo atëherë votojmë.

-Po 14

-Jo 0

-abstenim 0

Me vota unanime prosesverbali u pranua.

2.Shqyrtimi dhe miratimi i rendit të ditës;

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Shkojmë në votim për heqjen nga rendi i ditës pikën e katërt, komitetet e kanë hjekëë.
Atëherë votojmë për heqjen e pikës së katërt nga rendi i ditës. Me vota unanime kjo pikë e rendit të ditës u hoq.

Tani shkojmë në votim për rendin e ditës pa pikën e katërt.

A ka dikush diçka me shtu në rend te ditës nëse jo atëherë votojmë.

Me vota unanime rendi i dites u pranua.

3.Shqyrtimi dhe miratimi i memorandum mirëkuptimit për “Qendrën për strehimin e grave dhe fëmijëve”

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Për më tepër spjegime rreth kësaj pike fjalën ia japim Türker Mazrek-ut, Drejtor i Financave.

Türker Mazrek: (Drejtor i Financave)

Ju përshendes të gjithëve, Qendra për strehimin e grave dhe fëmijëve në Prizren ka bërë kërkesë për mbështetje Financiare prej katër komunave, Komuna e Mamushës, Prizrenit, Dragashit dhe Suharekës. Këto komuna kanë nëshkruar memorandum mirëkuptimi për financim tre vjeçar të strehimores. Financimi do të bëhet në baza vjetore. Shuma për financim është përcaktuar në bazë të popullsisë, pra komunës tonë i ka rënë 500,00 € mirëpo kryetari e ka rrit këtë shumë në 1,000,00€.

İlyas Bayraktar:

A është përcaktuar shuma në bazë të numrit të popullsisë?

Türker Mazrek: (Drejtor i Financave)

Po qdo komunë e ka përcaktuar shumën në bazë të numrit të popullsisë. Komunës tonë i ka rënë 500,00€ por kryetari e ka ngrit në 1,000€.

İlyas Bayraktar:

A ka kompetenca kryetari me rrit shumën në 1,000€?

Türker Mazrek: (Drejtor i Financave)

Kryetari e ka rritur këtë shumë dhe këtë po ua prezentojmë juve, nëse ju e pranoni atëherë shuma vjetore e ndarë nga komuna jonë për strehimoren do të jetë 1,000€. Sa ma shumë që shtohet shuma aq më mirë është.

Semra Morina:

Kjo a është strehimore apo shtëpi e pleqve?

Türker Mazrek: (Drejtor i Financave)

Kjo është Qendra për strehimin e grave dhe fëmijëve”

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Do ti bëjë edhe unë disa shpjegime rreth kësaj qështje. Neve na kanë ftuar disa muaj më parë në një takim në Suharekë. Aty kanë marrë pjesë komuna e Prizrenit, Suharekës, Dragashit dhe Mamushës. Na treguan për qështjen e strehimores edhe kanë kërkuar nga ne se sa mundemi ne me kontribu, unë i thash 1,000€. Mandej kemi biseduar edhe me kryetarin edhe atij i është dukur e përshtatshme kjo shumë. Tani po diskutojmë edhe me ju, nëse edhe juve iu duket e përshtatshme atëherë e votojmë. Urdhëro Halim.

Halim Sadiku:

I nderuar Z. Kryesues, të nderuar anëtarë,drejtorë dhe përfaqësues të OSBE-së. Na e kemi mirëpritur këtë bashkëpunim ndërmjet 4 komunave për strehimoren. Po unë kisha me thon diqka veqantë, qysh nuk i ka ardhë marre përshembull komuna e Dragashit me 1,230,00€edhe komuna e mamushes me 1,000€, komuna e Prizrenit 6,000€ pak ma mire diqka, kurse komuna e Dragashit marre i koft me 2200€ kur përshembull në qet strehimore edhe na i kemi 2a 3 persona. Kështu që pak me reduktu lluksin, llogarite ti në qfare kategori gjenden ata në qoftëse edhe na nuk i gjendemi afër atyve. Shojnë hargjojnë psh qeta kryetart e komunave shumica janë qetash ne amerikë, edhe i joni gjithashtu. Unë e di që po boan i tepërt edhe krejt thoni hajt bre se na lodhi mo, besoni që është para e tatimpagusve e qytetarit të mamushës o ni cent me hargju gabim duhet me lyp ku u hargju e mos të flasim për mija e mija euro që po shpenzohen. Garë asht tu bo prej kryetarëve të komunave cili po ban pasuri ma shumë, cili po ban kerr mat mirë, cili

pe ban lluksin mat mirë. Po nale analizone ku pi mirrni ato pare, kujna janë ato pare, me rroga nuk muni mi bo. Na jemi ata që duhet me ngrit zonin për qdo kryetar komune, jo me ardh me bo gara kryetarit e komunave cili po bajn pasuri ma tepër. Ky është aj turpi që na pe mlojmë gjithmonë, kështu që 1000 euro, unë për hësin të kisha lon do llukse qe pi bojmë, do udhëtime zyrtare, do dreka darka zyrtare do sene qe sna hin ne punë palidhje, megjithëse janë korit edhe kryetarit e komunave tjera, marre i koft Bali Muharremi, marre i koft Mytaher Haskukajt, marre i koft kryetarit të dreagashit se po ja harroj emrin, marre i koft Abdylhadi Krasniçit kryetarit të komunës së Mamushës me 1000€, kta janë njerëzit marrum, kta janë kriminelat, kta janë hajnat, kta janë të pa ftyrë. Qeta katër kryetarit e Komunave janë qka dush bre thuj, qka do që thush ju përshtatet për shkak se për strehimoren me nda qekaq pak mjete, kjo është katastrof. Faleminderit shumë.

Necmeddin Morina:

Krahasuar me komunat tjera Mamusha është komuna që ka dhënë më së shumti mjete, sepse kjo shkon në bazë të popullsisë. Buxheti ndahet në bazë të popullsisë.

Qamil Mazrek:

Mamusha është dashur ti jap 450€ por Krytari i ka ndarë 1000€.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Urdhëro İlyaz Bayraktar.

İlyaz Bayraktar.

I nderuar Z. Kryesues, të nderuar anëtarë, drejtorë, kryetari nuk është këtu po të kishte qenë ndoshta ka pasur diqka me na spjegju. Dashta dy pyetje me ja bo drejtorit të Arsimit por edhe ai nuk është. Ktu janë vetëm dy drejtorë dhe me dy drejtorë nuk po mundesh as me ju drejtu me pyetje. Qështja e parë siq e dini shtyllat elektrike deri në dalje të Mamushës nuk janë duke punuar si duhet, edhe qe një kohë të gjatë nuk janë të punu, po du me dit arsyen pse spo punojnë? Plus është edhe rruga që nuk po përfundon që sa kohë?

Halim Sadiku?

İlyaz jemi në pikën e tretë të rendit të ditës, nuk jemi në të ndryshmet.

İlyaz Bayraktar.

Edhe ti nuk ke në të ndryshmet po folë për mjete helmuese. E treta, qka është bërë më ndëgjueset e minares së xhamisë, ka një vit e më tepër që janë këputur dhe askush nuk po i rregullon. Edhe kjo duhet të shënohet. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Faleminderit İlyaz Bayraktar. A ka dikush tjetër diqka me shtu në lidhje me këtë pikë? A ta rrisim shumën e mjeteve për strehimore apo ta lëmë sa është? Paret po shpenzohen për shumë gjëra të tjera të kota kurse këtu nuk humbin. Nëse nuk keni diqka me shtu rreth kësaj pike atëherë votojmë.

İlyaz Bayraktar:

Nëse ju po mendoni dhe po dëshironi që ta rrisni shumën në 1000€ atëherë më mirë është që këto mjete të shkojnë në arsim, ti edukojmë nxënësit tanë dhe mos të vijë deri tek nevoja që të shkojnë ndonjëra nga nënat ose motrat tona në strehimore. Nëse neve na ka rënë me i qit 500€ ne e kemi ngrit shumën 1000€, nëse ndajmë më tepër sipas meje është gabim

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Ne ashtu ashtu kemi ndarë buxhet per arsim. Unë për këtë arsye po ju pyes edhe juve. Nëse thoni ta zbresim shumën atëherë e zbresim, nëse thoni ta ngrisim atëherë e ngrisim. Nëse nuk keni diqka me shtu rreth kësaj pike atëherë votojmë.

Me vota unanime kjo pikë u pranua.

4.Të ndryshme

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

A ka dikush diqka me shtu në të ndryshmet?

Halim SADÏKU:

Kryesues ni kritik e kam për juve, qe dy vite I bone edhe për qështjen e zërimit nuk ke bo apsolut sen, mos mendo që harrojmë na. Je zotu që këtë muj ka me përfundu krejtdhe ska perfundu, kjo është pa zotësi e jotja. Arsye nuk dojmë por dojmë punë. Zërimi duhet mu kry. E vetmja komunë e Mamushës qe katër vite nuk monitorohet orej pushtetit qëndror, cila është arseja, tek është arsyeja ju e dini vet. Fakeminderit. Tjetra: Ndriqimin nashta e dini që nuk funksionon në Mamushë përmi gjysa, cila është arsyeja, cili është problem, për këtë arse pot ham që na kemi nevojë në vend tonin me punu 24 orë, me shëtit nëpër qytetin e Mamushës me pa ku janë problemet, e jo me shku nëpër botë sepse nuk e kena at lluks. Na qytetart e Mamushës ja kemi dhonë votën Abdülhadi Krasniç për me punu, nuk ja kemi dhon votën me shetit. Përndryshe tash kur të vijnë zgjedhjet asht qytetari ai që ka me ndëshku prap, atë le ta dinë qdo kryetar komune. Tjetra, jipen me mijëra mijëra euro, nashta e keni parë në qarkoreë buxhetore të komunës për mbikqyrjen e kanalizimit, ni pik shi, sa pak shi, komplet dalin kanalizimet, cili është mbikqyrja, hajt kallxoni cili është mbikqyrja e kanalizimit që e bajmë mbikqyrjen, absolut. Tjetra, në qoftëse ju më përkrahni, në qoftëse jus i anëtarë të asamblesë, si kolegë, si shok që jemi, si votues të qytetarëve të Mamushës që ja kanë dhon besimin juve edhe mu, në të ardhmen, në séance e ardhshme porn ë qoftëse edhe ju pajtoheni se unë nuk e qes edhe me gjujt posht, me pru vendim që krejt para dyrve të shpiajv, lokaleve, pa marrë parasysh të arave, ka e ka kufinin e pronës personi në qoftëse nuk I hek mbeturinat jo mu ndëshku po me I dhënë një vërejtje . Sdi sa keni mujt me vërejt Mamushën ditën e bajramit asht në të gjitha anët e pastër, pse nuk e bojm ditë bajrami qdo ditë me pastru ambientin. Kështu që në qoftëse edhe ju jeni të pajtimit seancën e ardhshme qdo kush para oborrinë vet. Faleminderit shumë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Urdhëro İlyaz Bayraktar.

Të nderuar anëtarë të asamblesë, unë e respektoj propozimin e Halimit, por nuk mendoj që ne kemi kapacitet të mjaftueshëm për popullsinë e Mamushës sa është 6,000 banorë. Nëse punëtorët që pastrojnë nuk mjaftojnë atëherë le të na urdhëron kryetari ne ndajmë buxhet shtesë. Nuk ka ndonjë problem, ne jemi këtu për njëri tjetrin. Asnjë qytetar nuk del për me pastru rrugën, kjo është diqka që ka ndodhur në kohën e mesjetës. Ndërsa qysh e tha edhe anëtari I kuvendit ndriqimi në pjesën e cekur ka dy vite që nuk funksionon dhe kërkojmë nga kryetari që kjo qështje të rregullohet. Faleminderit.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Edhe ne të falendërojmë ty. Urdhëro Yalçin.

Yalçin Mazrek:

Ju përshendes të gjithëve, propozimi I Halimit ndoshta është I drejtë ndoshta I gabuar por siq e tha edhe İlyazi ne I kemi 3 apo 4 pastrues që po paguhen. Unë këtë që po ua them vet personalisht e kam përjetuar. Ka pasur një rast kur para fabrikës, pra vendit të tregut ka pasur mbeturina dhe unë I kam thirrur në

telefon, I kam thënë që në vendin e caktuar ka mbeturina pastruesët kanë ardhur dhe e kanë pastruar menjëherë.

Nehat Taç:

Pa I thirrur nuk po vijnë.

Yalçin Mazrek:

Ju jeni anëtarë I kuvendit së bashku me mua, nëse diku sheh që ka nevojë të pastrohet mundesh me thirr kryetarin e komunës, drejtorin ose pastruesin por unë as nuk e kam thirr drejtorin as kryetarin e komunës, direkt e kam thirr pastruesin ska vonu as 5 minuta kanë ardhë edhe e kanë pastru. Detyra jonë është që ta lajmërojmë qkashohim ndonjë gabim por nëse nuk vijnë atëherë mundesh me thirr drejtorin, kryetarin. Por nëse ne kalojmë përkaj mbeturinav edhe nuk bëjmë asgjë atëherë gabimi është I joni. Nëse e thirr edhe I thu që në filaan vendin ka një gabim ose ka një vend ku duhet të pastrohet ata vijnë edhe pastrojnë. Veqanërisht në muajin e fundit shumë janë duke punuar pastruesit, nuk po ndalen.

Semra Taç Morina:

Kur po pastrojkan athu, unë nuk po I shoh asnjëherë.

Yalçin Mazrek:

Muajt e fundit pa ndërprerë po punojnë, hiq spo ndalen.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Bile edhe të shtuneve po punojnë.

Semra Taç Morina:

Mjaft pom bjen me shku e me ardhë qdo orë por nuk po shoh askënd duke pastruar.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të falendërojmë Yalçin. Urdhëro İlyaz.

İlyaz Bayraktar:

Unë nuk pajtohem me fjalët e anëtarit. Ne si legjislativ se kemi për detyrë me I thirr pastruesit për me ardh me pastru ndonjë vend të caktuar. Ne si legjislativ e përcjellim ose e njoftojmë ekzekutivin dhe ekzekutivi duhet me pas me I angazhu pastruesët. Nëse ti ke muhabet ose e ke shok ndonjë nga pastruesit edhe e thirr me pastru vendin e caktuar atëherë ajo është diqka personale. Ai mundet me ardh një herë, dy herë, një muaj, dy muaj por kryesorja është me punu vazhdimisht dhe pa e thirrur askush.

Semra Taç Morina:

Ndoshta herën tjetër kur e thirr nuk vjen.

Yalçin Mazrek:

Nëse nuk vjen thirre Drejtorin.

Halim Sadiku:

Nashta e keni keqkuptu pak po nuk u kon mu keqkuptu kjo punë se unë po flas se është një vend I vogël edhe mujm me bo një Mamushë model. Përshembull u kon një fshat I komunës së suharekës fshatı më I pastër edhe është fshatı më I pastër edhe sot me shku është fshatı më I pastër në komunë të Suharekës, është fshatı Sopi. Kushdo që shkon aty kalon aty I jet synı qel, thojnë qfar marifeti. Unë nuk I thash as ni individi, unë I thash në radhë të parë vetvetes mandej juve krejtve sepse na jemi përfaqësues e 6,000

banorëve. Neve na kanë dhënë votën për mi përfaqësu ata, e kështu që për këtë arsye pot ham që let jetë Mamusha model. Shkojnë shkep in plehin kimik edhe thast I gjujn në lumë. Unë po du që na me u bo komunë model, komunë e vogël por e pasur dhe me kulturë shumë të lartë.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Të falendërojmë Halim. Urdhëro İlyaz.

İlyaz Bayraktar:

Siq e dini është një problem global që e ka kaplu tërë botën pra është problemi i Coronavirusit dhe kishte me qenë shumë mirë që ndonjë përfaqësues i Shendetësisë të kishte qenë këtu dhe të na kishte dhënë disa informata rreth shëndetit, sa pacientë janë të sëmure, qfarë masa parandaluese po mirren ndaj tyre etj. Kishte qenë mirë po të ishte drejtori apo kryetari prezent.

Buyar Mazrek: Kryesuesi i Kuvendit .

Po shikoj nëse është Drejtori këtu. Do ti jap unë disa informata rreth shëndetësisë. Të hënën do ti sjellin dezinfektantët në shkolla. Unë kam kërkuar që të formohen një komision në përbërje nga anëtarët e kuvendit së bashku me drejtorin e shëndetësisë dhe ti monitorojmë situatën edhe të shkollave edhe të QMF-së. Nuk ka ndonjë rast të Coronavirusit në Kosovë, plus ndoshta edhe në internet e keni parë, me urdhër të Ministrisë së Shëndetësisë që një ekip nga QMF-së nga Mamusha kanë shkuar edhe në kufi dhe i kanë kontrolluar qytetarët.

Buyar Mazrek: (Kryesues i Kuvendit)

Të nderuar anëtarë nëse nuk keni diqka me shtu në të ndryshmet atëherë mledhja ka përfunduar. Faleminderit për pjesmarrje.

**Proces mbajtësi
İdriz Mazrek**

**Kryesuesi i Kuvendit
Buyar Mazrek**

